



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova-Republic of Kosovo**  
*Qeveria - Vlada - Governme*

---

**STATUTI I SHËRBIMIT SPITALOR DHE KLINIK UNIVERSITAR I KOSOVËS<sup>1</sup>**

**STATUTE OF THE HOSPITAL AND UNIVERSITY CLINICAL SERVICE OF KOSOVO<sup>2</sup>**

**STATUT UNIVERZITETSKE BOLNIČKE I KLINIČKE SLUŽBE KOSOVA<sup>3</sup>**

---

<sup>1</sup> Statuti i Shërbimit Spitalor dhe Klinik Univerzitar i Kosovës ,është miratur në mbledhjen e 148 të Qeverisë së Republikës së Kosovës, me vendim nr.05/148 datë 11.09.2013

<sup>2</sup> Statute of the Hospital and University Clinical Service of Kosovo,was approved on 148 meeting of the Government of the Republic of Kosovo, with the decision no. 05/148, date 11.09.2013

<sup>3</sup> Statut Univerziteteske Bolničke i Kliničke Službe Kosova,usvojen je na 148 sednice Vlade Republike Kosova, odluku br.05/148 , datum 11.09.2013

<p><b>Qeveria e Republikës së Kosovës,</b></p> <p>Në mbështetje të nenit 93 (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, Në pajtim me Nenin 63 paragrafët 2 dhe 3 dhe nenin 23 të Ligjit Nr. 04/L-125 për Shëndetësi si dhe nenin 19 (6.2) të Rregullores së Punës së Qeverisë Nr. 09/2011 (GZ, nr.15, 12.09.2011),</p> <p>Miraton:</p> <p><b>STATUTI SHËRBIMIT SPITALOR DHE KLINIK UNIVERSITAR I KOSOVËS</b></p> <p><b>Neni 1 Qëllimi</b></p> <p>Me këtë Statut përcaktohen fushëveprimi organizimi, dhe funksionimi i njësive përbërëse të Shërbimit Spitalor dhe Klinik Universitar të Kosovës (në vijim “SHSKUK”), mënyra e kryerjes së veprimtarisë së tij, si dhe autorizimet, të drejtat, detyrat, dhe përgjegjësitë e strukturave menaxhuese të SHSKUK.</p>	<p><b>Government of Republic of Kosovo,</b></p> <p>Pursuant to Article 93 (4) of the Constitution of the Republic of Kosovo, In accordance with Article 63 paragraphs 2 and 23 of Law No. 04/L-125 on Health, and Article 19 (6.2) of the Government Rules of Procedure No. 01/2011 (OG, No. 15, 12.09.2011),</p> <p>Approves:</p> <p><b>STATUTE OF THE HOSPITAL AND UNIVERSITY CLINICAL SERVICE OF KOSOVO</b></p> <p><b>Article 1 Purpose</b></p> <p>The purpose of this Statute is to set out the scope, organisation, and functions of the constituent units of Hospital and University Clinical Service in Kosovo (hereinafter, the “HUCSK”), its activities, as well as authorizations, rights, tasks, and responsibilities of managing structures of the HUCSK.</p>	<p><b>Vlada Republike Kosovo,</b></p> <p>Na osnovu člana 93 (4) Ustava Republike Kosovo, U skladu sa člana 63 stava 2 i 3 i član 23 o Zakona o zdravstvu br. 04/L125 i sa članom 19 (6.2.) Pravilnika o Radu Vlade Br. 09/2011 (SL, Br.15, 12.09.2011),</p> <p>Usvaja:</p> <p><b>STATUT UNIVERZITETSKE BOLNIČKE I KLINIČKE SLUŽBE KOSOVA</b></p> <p><b>Član 1 Svrha</b></p> <p>Ovim Statutom se određuje delatnost organizacija i funkcionisanje sastavnih jedinica Univerzitetske bolničke i kliničke službe Kosova (u daljem tekstu “UBKSK”), način vršenja delatnosti, kao i ovlašćenja, prava i obaveze menadžerskih struktura UBKSK.</p>
---	---	---

<p style="text-align: center;"><b>Neni 2 Fushëveprimi</b></p> <p>Ky Statut zbatohet në të gjitha njësitë përbërëse të SHSKUK në pajtim me Ligjin.</p>	<p style="text-align: center;"><b>Article 2 Scope</b></p> <p>This Statute shall apply to all constituent units of HUCSK in accordance with Law.</p>	<p style="text-align: center;"><b>Član 2 Delokrug</b></p> <p>Ovaj Statut se primenjuje na sve sastavne jedinice UBKSK u skladu sa Zakonom.</p>
<p style="text-align: center;"><b>Neni 3 Përkufizimet</b></p> <p>Të gjitha shprehjet e përdorura në këtë Statut kanë kuptimin e përcaktuar në Ligjin për Shëndetësi Nr. 04/L-125 (në vijim “Ligji për Shëndetësi”), përveç nëse në këtë Statut përcaktohet ndryshe.</p>	<p style="text-align: center;"><b>Article 3 Definitions</b></p> <p>The terms used in this Statute shall have the meaning as defined in Law No. 04/L-125 on Health (hereinafter, “Health Law”), unless otherwise determined by this Statute.</p>	<p style="text-align: center;"><b>Član 3 Definicije</b></p> <p>1. Svi izrazi korišćeni u ovom Statutu imaju značenje određeno u Zakonu o zdravstvu br. 04/L-125 ( u daljem tekstu: “Zakon o zdravstvu”), osim ako ovim Statutom nije drugačije određeno.</p>
<p style="text-align: center;"><b>Neni 4 Statusi Juridik i SHSKUK</b></p> <ol style="list-style-type: none"> <li>SHSKUK është institucion shëndetësor me rëndësi të veçantë publike me seli në Prishtinë.</li> <li>SHSKUK në kuadër të veprimtarisë së tij shëndetësore ushtron edhe veprimtari arsimore dhe kërkimore-shkencore në pajtim me Ligjin për Shëndetësi.</li> <li>SHSKUK është person juridik me të drejta, detyrime dhe përgjegjësi të veçanta për zbatimin e Ligjit për Shëndetësi, ligjeve të tjera përkatëse, dhe akteve përkatëse nën-ligjore të nxjerra nga Ministria e Shëndetësisë (në vijim, “Ministria”).</li> </ol>	<p style="text-align: center;"><b>Article 4 Legal Status of HUCSK</b></p> <ol style="list-style-type: none"> <li>HUCSK is healthcare institution of a special public interest with headquarter in Prishtina.</li> <li>As part of its healthcare functions HUCSK exercises also educational and research-scientific activities in accordance with the Health Law.</li> <li>HUCSK is a legal person with specific rights, tasks, and obligations for the implementation of the Health Law, other relevant laws, and relevant secondary legislation issued by the Ministry of Health</li> </ol>	<p style="text-align: center;"><b>Član 4 Pravni status UBKSK</b></p> <ol style="list-style-type: none"> <li>UBKSK je zdravstvena ustanova od posebnog javnog značaja sa sedištem u Prištini.</li> <li>UBKSK u okviru svoje delatnosti obavlja i obrazovnu i naučno-istraživačku delatnost u skladu sa Zakonom o zdravstvu.</li> <li>UBKSK je pravno lice sa posebnim pravima, obavezama i odgovornostima za primenu Zakona o zdravstvu i odgovarajućim podzakonskim aktima donetim od strane Ministarstva zdravstva (</li> </ol>

<p>4. Në funksionimin juridik SHSKUK fiton të drejta dhe merr obligime, është pronarë i asetëve të luajtshme dhe të paluajtshme që kanë të bëjnë me veprimtarinë e tij shëndetësore dhe është palë në procedurat para gjykatave dhe para organeve të tjera shtetërore.</p> <p>5. SHSKUK ushtron veprimtarinë dhe përmbush obligimet dhe detyrat e tij në pajtim me normat, standardet, strategjitë dhe politikat e nxjerra nga Ministria dhe i nënshtrohet mbikqyrjes ligjore dhe profesionale në pajtim me Ligjin për Shëndetësi dhe legjislacionin tjetër në fuqi.</p> <p>6. SHSKUK dhe njësitë e tij organizative kanë vulat të cilat përdoren kur paraqiten si persona juridik.</p> <p>7. Për llojet, numrin, përbërjen, mënyrën e përdorimit si dhe autorizimin e personit për përdorimin dhe ruajtjen e vulave vendos Drejtori i përgjithshëm i SHSKUK, në pajtim me Ligjin për Vula në Institucionet e Republikës së Kosovës.</p> <p style="text-align: center;"><b>Neni 5 Përbërja e SHSKUK</b></p> <p>SHSKUK është institucion unik shëndetësor, që përbëhet nga institucionet e nivelit dytësor dhe tretësor të kujdesit shëndetësor në sektorin</p>	<p>(hereinafter, “the Ministry”).</p> <p>4. In legal functioning HUCSK gains rights and takes responsibilities, is an owner of financial assets and real estate which have to do with its health activity, and is a party in procedures before court or other state bodies.</p> <p>5. HUCSK shall exercise its functions and responsibilities in compliance with norms, standards, strategies and policies issued by the Ministry, and it is a subject to legal and professional surveillance in accordance with the Health Law and other legislation in power.</p> <p>6. HUCSK and its organizational units have stamps which are used when they appear as legal persons.</p> <p>7. The general director of HUCSK shall decide upon the type, number, content, usage, and authorization of a person for usage and preserving the stamps, in accordance with the Law on Stamps in Institutions of the Republic of Kosovo.</p> <p style="text-align: center;"><b>Article 5 Composition of the HUCSK</b></p> <p>HUCSK is a unique, integrated, healthcare institution, which is composed of public, secondary and tertiary, healthcare institutions</p>	<p>u daljem tekstu: “Ministarstvo”).</p> <p>4. U pravnom funkcionisanju UBKSK stiče prava i prihvata obaveze, vlasnik je pokretne i nepokretne imovine vezane za njenu delatnost i pravno je lice pred sudskim postupcima i drugim državnim organima.</p> <p>5. UBKSK obavlja delatnost i ispunjava obaveze i zadatke u skladu sa normama, standardima, strategijom i politikom usvojenom od Ministarstva i podleže zakonskom i stručnom nadzoru u skladu sa Zakonom o zdravstvu.</p> <p>6. UBKSK i njene organizacione jedinice imaju pečate koje koriste kada se predstavljaju kao pravna lica.</p> <p>7. O vrsti, broju, sadržaju i načinu upotrebe kao i oblašćenju lica za upotrebu i čuvanje pečata odlučuje generalni direktor UBKSK, u skladu sa Zakonom o pečatu za ustanove Republike Kosova.</p> <p style="text-align: center;"><b>Član 5 Sastav UBKSK</b></p> <p>UBKSK je jedinstvena zdravstvena ustanova koja se sastoji od ustanova sekundarnog i tercijarnog nivoa</p>
--	---	--

<p>publik të shëndetësisë si njësi organizative, si dhe nga Shërbimet Profesionale si njësi të tij administrative dhe funksionale, në pajtim me Ligjin për Shëndetësi.</p>	<p>as its organizational units, as well as of Professional Services as its administrative and functional units, in accordance with the Health Law.</p>	<p>zdravstvene zaštite u javnom zdravstvenom sektoru kao organizacione jedinice, kao i od profesionalnih službi kao administrativne i funkcionalne jedinice, u skladu sa Zakonom o zdravstvu.</p>
<p style="text-align: center;"><b>Neni 6 Institucionet Shëndetësore</b></p>	<p style="text-align: center;"><b>Article 6 Healthcare Institutions</b></p>	<p style="text-align: center;"><b>Član 6 Zdravstvene ustanove</b></p>
<p>1. Institucionet shëndetësore të nivelit dytësor dhe tretësor të kujdesit shëndetësor, të cilat përbëjnë SHSKUK-në, janë si vijon:</p>	<p>1. Secondary and tertiary healthcare institutions which constitute HUCSK, are the following:</p>	<p>1. Zdravstvene ustanove sekundarnog i terciarnog nivoa zdravstvene zaštite koje čine sastavni deo UBKSK su:</p>
<p>1.1.Qendra Klinike Universitare e Kosovës (në vijim „QKUK“);</p>	<p>1.1.University Clinical Centre of Kosovo (hereinafter „UCCK“);</p>	<p>1.1. Univerzitetski klinički centar Kosova ( u daljem tekstu “UKCK”);</p>
<p>1.2.Qendra Klinike Universitare Stomatologjike e Kosovës;</p>	<p>1.2.Dental University Clinical Centre of Kosovo;</p>	<p>1.2.Univerzitetski kliničko stomatološki centar Kosova;</p>
<p>1.3.Qendra Kombëtare e Mjekësisë së Punës në Gjakovë;</p>	<p>1.3.National Centre of Labour Medicine in Gjakova;</p>	<p>1.3.Nacionalni centar medicine rada u Đakovici;</p>
<p>1.4.Qendra Kombëtare e Mjekësisë Sportive;</p>	<p>1.4.National Centre of Sports Medicine;</p>	<p>1.4.Nacionalni centar sportske medicine;</p>
<p>1.5.Qendra Kombëtare e Transfuzionit të Gjakut;</p>	<p>1.5.National Centre for Blood Transfusion;</p>	<p>1.5 Nacionalni centar za transfuziju krvi;</p>
<p>1.6.Qendra Kombëtare e Telemjekësisë;</p>	<p>1.6.National Telemedicine Centre;</p>	<p>1.6.Nacionalni centar telemedicine;</p>
<p>1.7.Spitali i Përgjithshëm në Mitrovicë;</p>	<p>1.7.General Hospital in Mitrovicë;</p>	<p>1.7.Opšta bolnica u Mitrovici;</p>
<p>1.8.Spitali i Përgjithshëm në Gjiilan;</p>	<p>1.8.General Hospital in Gjiilan;</p>	<p>1.8.Opšta bolnica u Gnjilanu;</p>

<p>1.9.Spitali i Përgjithshëm në Pejë;</p> <p>1.10.Spitali i Përgjithshëm në Gjakovë;</p> <p>1.11.Spitali i Përgjithshëm në Prizren;</p> <p>1.12.Spitali i Përgjithshëm në Ferizaj;</p> <p>1.13.Spitali i Përgjithshëm në Vushtrri;</p> <p>1.14.Qendrat e Shëndetit Mendor me Shtëpitë për Integrim në Bashkësi;</p> <p>1.15.Qendra për Integrimin dhe Rehabilitimin e të Sëmurëve Kronik Psikiatrik në Shtime.</p> <p>2. Institucionet shëndetësore të cilat përbëjnë SHSKUK-në janë njësi autonome të cilat organizojnë dhe drejtojnë punët e tyre të rregullta administrative dhe profesionale në funksion të përmbushjes së detyrave dhe përgjegjësive ligjore, përveç detyrave dhe përgjegjësive të cilat sipas Ligjit për Shëndetësi dhe këtij Statuti i janë caktuar SHSKUK-së.</p> <p>3. Shërbimet nga Lista e shërbimeve të kujdesit themelor shëndetësor, të përcaktuara sipas nenit 3, paragrafi 1.19. dhe nenit 59 të Ligjit për Shëndetësi, si dhe Shërbimet nga Lista e Shërbimeve të Kujdesit Shëndetësor Plotësues</p>	<p>1.9.General Hospital in Pejë;</p> <p>1.10.General Hospital in Gjakovë;</p> <p>1.11.General Hospital in Prizren;</p> <p>1.12.General Hospital in Ferizaj;</p> <p>1.13.General Hospital in Vushtrri;</p> <p>1.14.Community based Mental Health Centres and Houses for Integration;</p> <p>1.15.The Centre for integration and rehabilitation of chronic psychiatric patients in Shtime.</p> <p>2. Healthcare institutions which constitute HUCSK are autonomous units that organize and manage their common and regular administrative and professional affairs in order to fulfill their duties and legal responsibilities, except for duties and responsibilities which have been assigned to HUCSK by the Health Law and this Statute.</p> <p>3. The services from the List of basic health care services, as defined under Article 3, paragraph 1.19. and Article 59 of the Health Law, as well as services from the List of supplementary healthcare services under</p>	<p>1.9.Opšta bolnica u Peći;</p> <p>1.10.Opšta bolnica u Đakovici;</p> <p>1.11.Opšta bolnica u Prizrenu;</p> <p>1.12.Opšta bolnica u Uroševcu,</p> <p>1.13.Opšta bolnica u Vučitrnu;</p> <p>1.14.Centri mentalnog zdravlja sa domovima za integrisanje u zajednici;</p> <p>1.15.Centar za integrisanje i rehabilitaciju hroničnih psihijatrijskih bolesnika u Štimlju.</p> <p>2. Zdravstvene ustanove koje su sastavni deo UBKSK su autonomne jedinice koje organizuju i upravljaju svojim uobičajenim i redovnim administrativnim i stručnim poslovima u funkciji ispunjavanja zakonskih obaveza i odgovornosti, osim zadataka i odgovornosti koje su prema Zakonu i ovim Statutom određeni UBKSK.</p> <p>3.Usluge sa Liste usluga osnovne zdravstvene zaštite, određene po članu 3. stav 1.19. i članu 59 Zakona o zdravstvu, kao i usluge sa Liste usluga dopunske zdravstvene zaštite po članu 59 stav 5</p>
--	---	--

<p>sipas nenit 59 paragrafi 5 të Ligjit për Shëndetësi ofrohen nga institucionet shëndetësore, njësi organizative të SHSKUK.</p> <p>4. Institucionet shëndetësore të cilat përbëjnë SHSKUK-në kanë për detyrë të mundësojnë dhe lehtësojnë themelimin, integrimin dhe funksionimin e Shërbimeve Profesionale të SHSKUK, si dhe të bashkëpunojnë me organet drejtuese të SHSKUK sipas këtij Statuti, në pajtim me Ligjin.</p> <p style="text-align: center;"><b>Neni 7 Shërbimet Profesionale</b></p> <p>1. Shërbimet Profesionale janë njësi funksionale dhe administrative të SHSKUK brenda një lëmie specialistike të kujdesit shëndetësor të cilat organizohen dhe funksionojnë në pajtim me nenin 3 paragrafi 1.28. dhe nenin 23 të Ligjit për Shëndetësi, në mënyrën e përcaktuar me këtë Statut dhe aktin nën-ligjor të nxjerr nga Ministria.</p> <p>2. Shërbimet Profesionale kanë kompetenca vendim-marrëse për standardet klinike-profesionale dhe akademike-shkencore, si dhe kompetenca këshillë-dhënëse ndaj Bordit Drejtues të SHSKUK.</p> <p>3. Shërbimet Profesionale janë organizim administrativ dhe profesional i institucioneve</p>	<p>Article 59 paragraph 5 of the Health Law, are provided by healthcare institutions, organizational units of HUCSK.</p> <p>4. Healthcare institutions which constitute HUCSK are required to enable and facilitate the establishment, operationalisation and integration of Professional Services into HUCSK, and cooperate with the governing bodies of HUCSK in accordance with the Law and this Statute.</p> <p style="text-align: center;"><b>Article 7 Professional Services</b></p> <p>1. Professional services are functional and administrative units of HUCSK within one specialistic healthcare field, which are organized and operate in accordance with Article 3 paragraph 1.28. and Article 23 of the Health Law, as determined by this Statute and sub-legal act issued by the Ministry.</p> <p>2. Professional services have decision-making powers for clinical, professional as well as scientific and academic standards, and advice-giving authorizations to the Steering Board of HUCSK.</p> <p>3. Professional service represents an administrative and professional organization of</p>	<p>Zakona o zdravstvu, pružaju sa od strane zdravstvenih ustanova, organizacionih jedinica UBKSK.</p> <p>4.Zdravstvene ustanove koje čine sastavni deo UBKSK su dužne da omoguće i olakšaju osnivanje, integrisanje i funkcionisanje profesionalnih službi UBKSK, kao i da sarađuju sa upravnim organima UBKSK prema ovom Statutu, u skladu sa Zakonom.</p> <p style="text-align: center;"><b>Član 7 Profesionalne službe</b></p> <p>1.Profesionalne službe su administrativne i funkcionalne jedinice UBKSK unutar jedne specijalističke oblasti zdravstvene zaštite, koje se organizuju i funkcionišu u skladu sa tačkom 3 stav 1.28. Zakona o zdravstvu, na način propisan ovim Statutom i podzakonskim aktima donetim od strane Ministarstva.</p> <p>2. Profesionalne službe imaju nadležnost u donošenju odluka u vezi sa kliničko-profesionalnim i ademsko—naučnim standardima kao i nadležnost u pružanju saveta Upravnom odboru UBKSK.</p> <p>3. Profesionalne službe su administrativna i profesionalna organizacija zdravstvenih</p>
--	---	--

<p>shëndetësore, që ka për qëllim sigurimin e kujdesit të integruar dhe të vazhdueshëm në fusha specifike të tri niveleve të kujdesit shëndetësor, në funksion të përmbushjes së detyrave dhe përgjegjësive të tyre ligjore, përveç detyrave dhe përgjegjësive të cilat sipas Ligjit i janë caktuar SHSKUK-së dhe njësive të tij organizative.</p> <p>4. Shërbimet profesionale synojnë dhe sigurojnë, në veçanti, ngritjen e vazhdueshme të cilësisë dhe performancës së shërbimeve të kujdesit shëndetësor nga neni 6 paragrafi 3 i këtij Statuti.</p> <p>5. Bartës të Shërbimit të caktuar Profesional janë klinikat përkatëse të QKUK dhe institucionet përkatëse të nivelit tretësor të kujdesit shëndetësor, njësi organizative të SHSKUK, ose njësitë përbërëse të këtyre klinikave dhe institucioneve shëndetësore, pas miratimit të Bordit Drejtues të SHSKUK.</p> <p>6. Shërbimet Profesionale integrojnë dhe koordinojnë shërbimet shëndetësore që ofrohen nga njësitë organizative të SHSKUK, me shërbimet e njëjta ose të ngjashme që ofrohen në njësitë përkatëse organizative të spitaleve të përgjithshme.</p> <p>7. Shërbimet Profesionale synojnë integrimin dhe koordinimin e shërbimeve nga paragrafi 6 i këtij neni me shërbimet e njëjta ose të ngjashme</p>	<p>healthcare institutions, aimed at providing integrated and continuous care in specific areas in the three levels of health care, in order to fulfill their duties and legal responsibilities, except for the duties and responsibilities assigned by law to HUCSK and its organizational units.</p> <p>4. Professional Services aim at and ensure in particular the continuous upgrading of quality and performance of health care services from Article 6 paragraph 3 of this Statute.</p> <p>5. Headquarters of a given Professional Service are relevant UCCK clinics and institutions of tertiary health care, organizational units of HUCSK, or constituent units of these clinics and health institutions, after approval of the Steering Board of HUCSK.</p> <p>6. Professional services integrate and coordinate health services provided by organizational units of HUCSK, with the same or similar services offered in the respective organizational units of general hospitals.</p> <p>7. Professional Services aim at integration and coordination of services from paragraph 6 of this article with the same or similar healthcare</p>	<p>ustanova, koje imaju za cilj da osiguraju pružanje integrisane i kontinuirane zaštite iz specifičnih zdravstvenih oblasti sva tri nivoa zdravstvene zaštite, u funkciji ispunjenja svojih zakonskih obaveza i odgovornosti, osim dužnosti i odgovornosti koje su zakonom propisane za UBKSK i njene organizacione jedinice.</p> <p>4. Profesionalne službe imaju za cilj da posebno obezbede kontinuirano poboljšanje kvaliteta i performanse usluga zdravstvene zaštite po članu 6 stavu 3 ovog Statuta.</p> <p>5. Nosioci određene profesionalne službe su određene klinike UKCK i određene ustanove tercijarnog nivoa zdravstvene zaštite, organizacione jedinice UBKSK, ili sastavne jedinice tih klinika i zdravstvenih ustanova, nakon usvajanja od strane Upravnog odbora UBKSK.</p> <p>6. Profesionalne službe integrišu i koordiniraju zdravstvene usluge koje pružaju organizacione jedinice UBKSK, sa istim ili sličnim uslugama koje pružaju nadležne organizacione jedinice u opštim bolnicama.</p> <p>7. Profesionalne službe imaju za cilj integraciju i koordinaciju službi iz stava 6 ovog člana sa istim ili sličnim</p>
--	--	---



<p>shëndetësore që ofrohen në nivelin parësor të kujdesit shëndetësor.</p> <p style="text-align: center;"><b>Neni 8</b> <b>Detyrat dhe përgjegjësitë e SHSKUK</b></p> <p>1. SHSKUK ka për detyrë që të ofrojë shërbime cilësore të kujdesit shëndetësor duke synuar performancë, efikasitet dhe efikasitet sa më të lartë të shërbimeve, në pajtim me Ligjin për Shëndetësi SHSKUK kujdeset që shërbimet e kujdesit shëndetësor të ofrohen me transparencë, të krijojë efekte të sinergjisë përmes bashkërendimit të shërbimeve të specializuara, të sigurojë bartjen e dijes dhe përvojës profesionale dhe shkencore; dhe në këtë mënyrë të garantojë nivelin e lartë të cilësisë së shërbimeve të kujdesit shëndetësor në të gjitha njësitë e tij organizative.</p> <p>2. Për të realizuar objektivat nga paragrafi 1 i këtij neni SHSKUK mbështet themelimin dhe organizimin e Shërbimeve Profesionale në lëmitë specialistike të përcaktuara me aktin e veçantë nën-ligjor të nxjerr nga Ministria.</p> <p>3. SHSKUK mbështet dhe nxitë veprimtarinë arsimore dhe shkencore të katedrave të Fakultetit të Mjekësisë të Universitetit të Prishtinës, të institucioneve të tjera të akredituara të shkollimit shëndetësor dhe të institucioneve kërkimore-</p>	<p>services provided at the primary health care level.</p> <p style="text-align: center;"><b>Article 8</b> <b>Functions and Responsibilities of the HUCSK</b></p> <p>1. HUCSK is responsible for provision of quality healthcare services by aiming at performance, efficiency and effectiveness, in accordance with the Health Law HUCSK shall ensure that healthcare services are provided in a transparent manner. It shall also endeavor to create synergy effects through the coordination of specialized healthcare services, and to ensure a high level of transfer and sharing of professional knowledge and experience, and in this way guarantee the high quality of healthcare services in all its constituent units.</p> <p>2. To realize the objectives from paragraph 1 of this article HUCSK supports the foundation and organisation of Professional Services in respective specialist fields based on the separate sub-legal act issued by the Ministry.</p> <p>3. HUCSK supports and promotes educational and scientific activities of the departments of the Faculty of Medicine at the University of Prishtina, other accredited institutions of medical education and local and foreign</p>	<p>zdravstvenim uslugama koje se pružaju na primarnom nivou zdravstvene zaštite.</p> <p style="text-align: center;"><b>Član 8</b> <b>Zadaci i odgovornosti UBKSK</b></p> <p>1. UBKSK ima za zadatak da pruža kvalitetne usluge zdravstvene zaštite, težeći što boljoj performansi, većoj racionalnosti i efikasnosti u pružanju usluga u skladu sa Zakonom o zdravstvu. UBKSK se trudi da usluge zdravstvene nege budu transparentne, da stvara sinergijske efekte preko koordinacije specijalističkih usluga, da obezbeđuje prenošenje znanja i stručnog i naučnog iskustva i na ovaj način garantuje visok nivo kvaliteta usluga zdravstvene zaštite u svim njenim orgaizacionim jedinicama.</p> <p>2. Da bi se realizovali objektivi iz stava 1 ovog člana UBKSK podržava osnivanje i organizovanje profesionalnih službi iz specijalističkih oblasti, propisane posebnim podzakonskim aktima donetim od strane Ministarstva.</p> <p>3. UBKSK podržava i podstiče obrazovnu i naučnu delatnost katedri Medicinskog Fakulteta Univerziteta u Prištini, drugih akreditovanih obrazovnih zdravstvenih institucija i naučno-istraživačkih državnih</p>
--	--	---

<p>shkencore, vendore dhe të huaja, në kuadër të njësisve të tij organizative dhe funksionale që janë pjesë e SHSKUK. Veprimtaria arsimore dhe shkencore brenda SHSKUK do të zbatohet në pajtim me aktet ligjore në fuqi, statutet e institucioneve shëndetësore që janë pjesë e SHSKUK, si dhe aktet e brendshme të SHSKUK të miratuara në pajtim me këtë Statut.</p>	<p>research institutions, within its organizational and functional units, constitutive parts of HUCSK. Educational and scientific activities within HUCSK shall be implemented in accordance with applicable laws, statutes of healthcare institutions, part of HUCSK, and internal acts of HUCSK approved in accordance with this Statute.</p>	<p>ili stranih institucija u sklopu organizacionih jedinica UKCK i drugih zdravstvenih ustanova i specijalističkih usluga koje su deo UBKSK. Obrazovna i naučna delatnost unutar UBKSK primenjuje se u skladu sa važećim zakonskim aktima, statutima zdravstvenih institucija koje su deo UBKSK i unutrašnjih akata UBKSK donetih u skladu sa ovim Statutom.</p>
<p style="text-align: center;"><b>Neni 9</b> <b>Organizimi i SHSKUK</b></p>	<p style="text-align: center;"><b>Article 9</b> <b>Organization of the HUCSK</b></p>	<p style="text-align: center;"><b>Član 9</b> <b>Organizacija UBKSK</b></p>
<p>SHSKUK organizohet në bazë të modelit të rrjetës funksionale që integron funksionet administrative dhe financiare me funksionet profesionale dhe shkencore në sektorin publik të shëndetësisë nëpërmjet bashkëpunimit të ngushtë ndërmjet institucioneve shëndetësore – njësi organizative të SHSKUK dhe shërbimeve përkatëse profesionale, sipas nenit 7 të këtij Statuti.</p>	<p>HUCSK shall be organized based on the functional network model that integrates financial and administrative functions with professional and scientific functions within the healthcare sector, through close cooperation among healthcare institutions – organizational units of HUCSK and respective professional services, according to Article 7 of this Statute.</p>	<p>UBKSK se organizuje na osnovu modela funkcionalne mreže koja integriše administrativne i finansijske funkcije sa profesionalnim i naučnim funkcijama u javnom zdravstvenom sektoru, preko uske saradnje između zdravstvenih ustanova-organizacionih jedinica UBKSK i odgovarajućih profesionalnih službi, po članu 7 ovog Statuta.</p>
<p style="text-align: center;"><b>Neni 10</b> <b>Statusi Juridik i të Punësuarve në SHSKUK</b></p>	<p style="text-align: center;"><b>Article 10</b> <b>The legal status of the employees in HUCSK</b></p>	<p style="text-align: center;"><b>Član 10</b> <b>Pravni status zaposlenih u UBKSK</b></p>
<p>1. Të punësuarit në SHSKUK nuk i takojnë shërbimit civil të Kosovës, në pajtim me nenin 62 paragrafi 6 të Ligjit për Shëndetësi.</p> <p>2. I punësuarit në SHSKUK realizon detyrat dhe përgjegjësitë nga marrëdhënia e punës me</p>	<p>1. Employees of HUCSK do not belong to the civil service of Kosovo, in accordance with Article 62 paragraph 6 of the Health Law.</p> <p>2. An employee of HUCSK performs its duties and responsibilities within HUCSK, based on</p>	<p>1. Zaposleno osoblje u UBKSK ne pripada civilnoj službi Kosova, u skladu sa članom 62 stav 6 Zakona o Zdravstvu.</p> <p>2. Zaposleno osoblje u UBKSK obavlja dužnosti i odgovornosti iz radnog odnosa</p>

<p>SHSKUK, nëpërmjet vendosjes së marrëdhënies kontraktuale me Institucionin përkatës shëndetësor – njësi organizative e SHSKUK, në pajtim me Ligjin e Punës dhe Ligjin për Shëndetësi.</p> <p>3. Kontrata nga paragrafi 1 i këtij neni duhet të ofrojë mundësin për pagesa stimulative në bazë të performancës së të punësuarit në SHSKUK, sipas kritereve të përcaktuara nga Shërbimi përkatës profesional dhe Agjencioni i Financimit Shëndetësor (në vijim AFSH), në pajtim me Ligjin për Shëndetësi.</p> <p>4. Në rast të afarizmit pozitiv financiar, institucioni shëndetësor – njësi organizative e SHSKUK, ka të drejtë që në pajtim me vendimin e Bordit të tij Drejtues, të realizojë punësimin e pavarur të profesionistëve shëndetësorë në kuadër të SHSKUK në bazë të rekomandimit të Shërbimit përkatës Profesional, me kusht që kjo nuk rrezikon qëndrueshmërinë financiare të SHSKUK.</p> <p>5. Të punësuarit nga paragrafi 4 i këtij neni nuk mund të financohen nga kategoria e pagave dhe mëditjeve e përcaktuar me Ligjin për Buxhetin të vitit rrjedhës për Ministrinë e Shëndetësisë. Financimi i kësaj kategorie të punëtorëve varet vetëm nga afarizmi financiar i institucionit shëndetësor, njësi organizative e SHSKUK.</p>	<p>the contractual relationship with the health care institution – organizational unit of HUCSK, in accordance with the Labor Law and the Health Law.</p> <p>3. The contract from paragraph 1 of this article shall provide the opportunity for stimulative performance based payments to employees in HUCSK, according to the determined criteria established by the relevant Professional service and Health Financing Agency (hereinafter, HFA), in accordance with the Health Law.</p> <p>4. In case of a positive financial result, healthcare institution – organizational unit of HUCSK, based on the decision of its Steering Board, has the right to conduct independent hiring of healthcare professionals within HUCSK on the recommendation of the relevant Professional Service, given that this does not put in risk the financial stability of HUCSK.</p> <p>5. Employees from paragraph 4 of the present article can not be financed from the category of wages and salaries determined by the current year Budget Law for the Ministry of Health. Funding of this category of workers depends only on financial results of the health care institution, organizational unit of HUCSK.</p>	<p>sa UBKSK, uspostavljanjem ugovornog odnosa sa odgovarajućom zdravstvenom ustanovom-organizacionom jedinicom UBKSK, u skladu sa Zakonom o radu i Zakonom o zdravstvu.</p> <p>3. Ugovor iz stava 1 ovog člana omogućava stimulativnu zaradu, na osnovu performanse zaposlenih u UBKSK, prema kriterijumima propisanim od strane odgovarajuće profesionalne službe i Agencije za finansiranje zdravstva (u daljem tekstu:AFZ), u skladu sa Zakonom o Zdravstvu.</p> <p>4. Zdravstvena ustanova- organizaciona jedinica UBKSK ,u slučaju pozitivnog finansijskog poslovanja, ima pravo da u skladu sa odlukom Upravnog odbora ostvari nezavisno zapošljavanje zdravstvenih stručnjaka u okviru UBKSK , na osnovu preporuke odgovarajuće profesionalne službe, pod uslovom da se ne ugrožava finansijska održivost UBKSK.</p> <p>5. Zaposleni iz stava 4 ovog člana ne mogu se finansirati iz kategorije plata i dnevnica utvrđenih Zakonom o budžetu za tekuću godinu Ministarstva Zdravstva. Finansiranje ove kategorije radnika zavisi samo od finansijskog poslovanja zdravstvene ustanove, organizacione jedinice UBKSK.</p>
---	--	---

<p>6. Në rastin e afarizmit pozitiv financiar të institucionit shëndetësor, njësi organizative e SHSKUK, ky institucion shëndetësor ka të drejtë të realizojë prokurimin plotësues të pajisjeve medicinale, produkteve medicinale, dhe materialit harxhues, në bazë të rekomandimit të Shërbimit përkatës Profesional, përveç në rastin e rrezikut për qëndrueshmërinë financiare të SHSKUK të përcaktuar nga Bordi i tij Drejtues.</p> <p>7. Prokurimi nga paragrafi 6 i këij neni nuk mund të financohet nga kategoritë buxhetore të përcaktuara me Ligjin për Buxhetin të vitit rrjedhës për Ministrinë e Shëndetësisë. Financimi i këtyre prokurimeve varet vetëm nga afarizmi financiar i institucionit shëndetësor, njësi organizative e SHSKUK.</p>	<p>6. In case of a positive financial result, the healthcare institution – organizational unit of HUCSK, based on the decision of its Steering Board has the right to perform additional procurement of medical equipment, medicinal products, and consumable material, on the recommendation of the relevant Professional Service, given that this does not put in risk the financial stability of HUCSK.</p> <p>7. Procurement from paragraph 6 of this article can not be financed through budget categories defined by the Law on Budget of the current year for the Ministry of Health. Funding of these procurements depends only on financial results of the relevant health care institution, organizational unit of HUCSK.</p>	<p>6.Zdravstvena ustanova- organizaciona jedinica UBKSK, u slučaju pozitivnog finansijskog poslovanja, ima pravo da izvrši dodatnu nabavku medicinske opreme, medicinskih proizvoda i potrošnjeg materijala, na osnovu preporuke odgovarajuće profesionalne službe, pod uslovom da se ne ugrožava finansijska održivost UBKSK određena od strane Upravnog odbora.</p> <p>7. Nabavke iz stava 6 ovog člana ne mogu se finansirati iz budžetskih kategorija utvrđenih Zakonom o budžetu za tekuću godinu Ministarstva Zdravstva. Finansiranje ovih nabavki zavisi samo od finansijskog poslovanja zdravstvene ustanove, organizacione jedinice UBKSK.</p>
<p><b>Neni 11</b> <b>Drejtimi i SHSKUK</b></p>	<p><b>Article 11</b> <b>Managing of HUCSK</b></p>	<p><b>Član 11</b> <b>Upravljanje UBKSK</b></p>
<p>1. SHSKUK drejtohet nga Bordi Drejtues.</p> <p>2. Bordi Drejtues është organi më i lartë vendim-marrës i SHSKUK.</p> <p>3. Bordi Drejtues përbëhet nga shtatë (7) anëtarë:</p> <p style="padding-left: 20px;">3.1.një (1) përfaqësues nga QKUK;</p> <p style="padding-left: 20px;">3.2.një (1) përfaqësues nga Qendra Klinike Universitare Stomatologjike e Kosovës;</p>	<p>1. The HUCSK shall be steered by the Steering Board.</p> <p>2. The Steering Board is the highest decision making body of HUCSK.</p> <p>3. The Steering Board consists of seven (7) members:</p> <p style="padding-left: 20px;">3.1.one(1) representative from the University Clinical Center of Kosovo;</p> <p style="padding-left: 20px;">3.2.one (1) representative from the Dental University Clinical Center of Kosovo;</p>	<p>1.Upravni odbor upravlja UBKSK.</p> <p>2. Upravni odbor je najviši organ odlučivanja UBKSK.</p> <p>3. Upravni odbor se satoji od sedam (7) članova:</p> <p style="padding-left: 20px;">3.1.jedan (1) predstavik UKCK;</p> <p style="padding-left: 20px;">3.2.jedan (1) Predstavnik Kliničko Univerzitetskog Stomatoloskog Centra</p>

<p>3.3.një (1) përfaqësues nga Instituti Kombëtar i Shëndetësisë Publike;</p> <p>3.4.një (1) përfaqësues nga Spitalet e përgjithshme, në bazë të rotacionit dhe përmbushjes së indikatorëve të kualitetit të shërbimeve shëndetësore;</p> <p>3.5.një (1) përfaqësues nga Shërbimet e kujdesit parësor shëndetësor, në bazë të propozimit të Asociacionit të Komunave të Republikës së Kosovës;</p> <p>3.6.një (1) përfaqësues i Ministrisë së Shëndetësisë;</p> <p>3.7.një (1) Drejtor Financiar – ekspertë i ekonomikës ose menaxhmentit shëndetësor me kualifikime të larta profesionale dhe shkencore i zgjedhur në bazë të konkursit publik.</p> <p>4. Bordi Drejtues i përgjigjet dhe i jep llogari Qeverisë nëpërmjet Ministrit të Shëndetësisë.</p> <p>5. Mandati i anëtarëve të Bordit Drejtues zgjatë tre (3) vite.</p> <p>6. Bordi Drejtues udhëhiqet nga Kryesuesi me mandat një (1) vjeçar i cili zgjedhet në bazë të parimit të rotacionit nga anëtarët e tij.</p>	<p>3.3.one (1) representative from the National Institute of Public Health;</p> <p>3.4.one (1) representative from regional hospitals, based on the rotation and fulfillment of healthcare services quality indicators;</p> <p>3.5.one (1) representative from the primary health care services, based on the proposal of the Association of Municipalities of the Republic of Kosovo;</p> <p>3.6.one (1) representative from the Ministry of Health;</p> <p>3.7.one (1) Financial Director – healthcare management expert with high scientific and professional qualifications selected through a public announcement.</p> <p>4. The Steering Board reports and is accountable to the Government through the Minister of Health.</p> <p>5. The mandate of the members of the Managing Board shall be three (3) years.</p> <p>6. The Steering Board is directed by the Chairman with a one (1) year mandate which is selected based on the principle of rotation</p>	<p>Kosova;</p> <p>3.3 jedan (1) predstavnik Nacionalnog Instituta Javnog Zdravstva;</p> <p>3.4 jedan (1) predstavnik opštih bolnica, na osnovu rotacije i ispunjavanja indikatora kvaliteta zdravstvenih službi;</p> <p>3.5. jedan (1) predstavnik primarnih zdravstvenih Službi po predlogu Asocijacije Opština Republike Kosova;</p> <p>3.6. jedan (1) predstavnik Ministarstva Zdravstva;</p> <p>3.7.jedan (1) finansijski direktor-stručnjak ekonomije ili menadžmenta zdravstva sa visokim stručnim i naučnim kvalifikacijama izabran na javnom konkursu.</p> <p>4. Upravni odbor odgovara i polaže račune Vladi preko Ministra Zdravstva.</p> <p>5. Mandat članova Upravnog odbora traje tri (3) godine.</p> <p>6. Upravni odbor vodi predsedavajući sa jednogodišnjim (1) mandatom koji se bira od članova po principu rotacije.</p>
---	--	---

<p>7. Bordi Drejtues mund të emërojë në cilësinë e vëzhguesit ekspertë vendor ose ndërkombëtar për mbështetjen e punës së tij përkitazi me çështje specifike.</p> <p style="text-align: center;"><b>Neni 12</b> <b>Detyrat dhe Përgjegjësitë e Bordit Drejtues</b></p> <p>1. Bordi Drejtues ka për detyrë të sigurojë mbarëvajtjen e gjithëmbarshme të punëve në SHSKUK përfshirë aktivitetet shëndetësore, arsimore dhe kërkimoro – shkencore, si dhe aktivitetet e ndërlidhura financiare dhe administrative të njësive të tij organizative dhe funksionale, me qëllim të orientimit të përgjithshëm të zhvillimit të SHSKUK, si dhe reagimit optimal ndaj nevojave shëndetësore të qytetarëve dhe banorëve të Republikës së Kosovës.</p> <p>2. Përgjegjësitë e Bordit Drejtues përfshijnë si në vijim:</p> <p>2.1. Ofron performancë efektive nëpërmjet sigurimit të shkathtësive adekuate, rrjedhës efektive të informatave dhe dinamikës së duhur brenda Bordit Drejtues;</p> <p>2.2. Përgatitë propozimet e akteve të brendshme për organizimin e njësive</p>	<p>from its members.</p> <p>7. The Managing Board may appoint national or international experts as observers to support its work in relation to specific issues.</p> <p style="text-align: center;"><b>Article 12</b> <b>Tasks and Responsibilities of the Steering Board</b></p> <p>1. The Steering Board is obliged to ensure the general well-functioning of HUCSK activities, including health, education and research-scientific activities, as well as related financial and administrative issues of its organisational and functional units; aiming for general direction of the development of HUCSK, as well as optimal reaction towards the healthcare needs of the citizens and residents of the Republic of Kosovo.</p> <p>2. The responsibilities of the Steering Board includes as follows:</p> <p>2.1. Offers effective performance through ensuring adequate skills, effective flow of information and right dynamic within the Steering Board;</p> <p>2.2. Prepare proposals of internal acts for organisational (healthcare institutions) and</p>	<p>7. Upravni odbor može da imenuje u svojstvu posmatrača stručnjake iz zemlje ili inostranstva za pomoć u njegovom radu vezanog za specifične slučajeve.</p> <p style="text-align: center;"><b>Član 12</b> <b>Zadaci i odgovornosti Upravnog odbora</b></p> <p>1. Upravni odbor je dužan da obozbedi normalan rad UBKSK obuhvatajući zdravstvene, obrazovne i naučno-istraživačke aktivnosti kao i administrativno-finansijske aktivnosti organizacionih jedinica u funkciji opšte orijentacije razvoja UBKSK kao i optimalne reakcije prema zdravstvenim potrebama građana i stanovnika Republike Kosova.</p> <p>2. Odgovornosti Upravnog odbora obuhvataju:</p> <p>2.1. Pruža efektivnu performansu obezbeđivanjem adekvatnih vrlina, efektivnog toka informacija i potrebne dinamike unutar Upravnog odbora;</p> <p>2.2. Priprema predloge unutrašnjih akata za organizovanje organizacionih</p>
---	--	--

